

VENDIM
Nr. 399, datë 18.6.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 197, DATË 16.3.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PJESEMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR “KFOR”, KOSOVË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, pikat 6 e 11, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a”, e pikës 5, të vendimit nr. 197, datë 16.3.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama